

BANKAT DHE FINANCIMI I POLITIKAVE TË RRRITJES MODELET BASHKËKOHORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK E SOCIAL

*Adrian Civiçi**
*Ina Kraja***

ABSTRAKT

Termet strategji zhvillimi apo model zhvillimi që duhet mbështetur, po gjejnë gjithnjë e më tepër vend në debatet politike mbi nivelin ekonomik e social të Shqipërisë, në programet dhe politikat e Qeverisë Shqiptare, në rekomandimet dhe sugjerimet e donatorëve, në analizat mbi ecurinë dhe orientimin e kredisë, përparësitë e financimeve etj.. Natyrisht që kjo nuk përbën thjesht një element të modernizimit të fjalorit apo konformitetit me shqetësimet bashkëkohore, përsa i përket politikave ekonomike e sociale, por shpreh një etapë të re dhe një pikëpyetje thelbësore përballë të cilës ndodhet Shqipëria: cila është strategjia më e mirë e zhvillimit ekonomik e social përballë sfidave të integritit dhe efekteve të globalizimit, cilat janë rrugët më efektive të financimit të saj, cili duhet të jetë roli dhe orientimi i sistemit bankar në këtë financim? Rolin referues e sintetizues të këtij procesi aktualisht po e luan “Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social” (SKZHES) dhe buxheti afatmesëm, me një përfshirje e rol gjithnjë e më të rëndësishëm edhe të bankave të të gjitha niveleve, që janë kreditueset kryesore të rritjes ekonomike e zhvillimit.

Aktualisht, Shqipëria po ndeshet me sfidën e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe mënyrave më efektive të financimit të

saj. Shumë çështje kërkojnë analiza, përgjigje e propozime konkrete: A përputhen drejtimet e financimit me një model zhvillimi të konsoliduar e me një vizion afatgjatë? A i përdorim ne burimet e financimit në përputhje me përparësitë tona të zhvillimit? A ekziston bashkëpunimi i nevojshëm midis aktorëve të zhvillimit, biznesit dhe bankave? A sigurojnë instrumentet dhe politikat tona monetare realizimin e objektivave parësorë të zhvillimit? etj..

Synimi i këtij materiali është pikërisht, analiza e evolucionit të modeleve bashkëkohore të zhvillimit ekonomik e social, e parë në spektrin e përvojës botërore, e sfidave të konceptimit dhe zbatimit të një sistemi eficient në Shqipëri. Mbi të gjitha, bashkëveprimi dhe vendosja e një dialogu institucional ndërmjet bankave, biznesit dhe politikës, në funksion të harmonizimit të politikave monetare, financiare, ekonomike e sociale, në kuadër të gjetjes dhe të mbështetjes së modelit më të mirë të zhvillimit për Shqipërinë, është shumë i rëndësishëm. Stabiliteti financiar dhe rritja ekonomike po përbëjnë, gjithnjë e më shumë një binom, që synohet të jetë sa më i stabilizuar. Bankat kanë vazhdimisht nevojë për informacion specifik në drejtëm të sektorëve të ekonomisë ku investohet dhe parashikohet të investohet, në kuadër të një vizioni afatgjatë zhvillimi.

Ky informacion do t'i ndihmonte bankat në procesin e shqyrtimit të kërkesave nga ekonomia e biznesi dhe njëkohësisht, do t'i ndihmonte ato në programimin e të ardhmes së biznesit të tyre.

Parë nga ky këndvështrim, banka qendrore nuk është vetëm institucion që “lufton” inflacionin, por është institucioni më i rëndësishëm financiar me ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e ekonomisë, është institucioni që siguron një klimë të favorshme për zhvillimin e biznesit, për nxitjen e investimeve publike e private, të vendit dhe të huaja, të kreditimit etj..

Ajo siguron një klimë pozitive në funksion të programeve afatgjata të zhvillimit, të politikave ekonomike në përputhje me SKZHES, me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, të Integritimit Evropian etj., dhe bashkërendon dhe harmonizon politikën monetare me atë fiskale, politikën ekonomike në funksion të zhvillimit të ekonomisë, në rolin si partnere dhe këshilluese e Qeverisë.

EVOLUCIONI I KONCEPTVE DHE I “MODELEVE TË ZHVILLIMIT”

Aktualisht, të gjitha vendet e botës dhe në mënyrë të veçantë vendet në zhvillim, nën efektin e fenomenit të globalizimit dhe ekspozimit ndaj ekonomive e shoqërive të zhvilluara perëndimore, po reflektojnë thellësisht për strategjitë dhe politikat e tyre drejt zhvillimit ekonomik e social. Ndërkohë, në thelb të të gjitha debateve qëndron vetë “koncepti i zhvillimit”, mënyra se si janë thithur nga shtete e popuj të ndryshëm teoritë themelore mbi zhvillimin apo eksperiencat e vendeve të pasura kapitaliste perëndimore. Çështja e konturimit të “modelit të zhvillimit” mbetet akoma pikëpyetje e madhe për shumë vende apo institucione ndërkombëtare dhe është e natyrshme që edhe në Shqipëri, debatet dhe sugjerimet e çdo drejtimi qofshin, përpiqen t’i japin një përgjigje kësaj çështjeje kryesore.

Çështja e modelit të zhvillimit dhe e bazës teorike të tij, “ekonomisë së zhvillimit” është shfaqur si një degë e re e shkencës ekonomike, pas viteve `50 të shekullit XX. Punimet e “pionerëve” të parë u fokusuan në dy drejtime: disa prej tyre e konsideronin moszhvillimin thjesht si një vonesë kohore në procesin e zhvillimit; ndërkohë që një grup tjetër të quajtur “strukturalistë”, e shikonin moszhvillimin si një fenomen historik, të lidhur me çrregullimet dhe shpërpjestimet e strukturave prodhuese. Zgjidhjet e propozuara ishin kryesisht të natyrës intervencioniste, projekte të përqendruara shtetërore, strategji të zëvendësimit të importeve me prodhim vendas pavarësisht nga kostot e tij etj.. Por, gjatë viteve 1960 – 1970, debatet e arsyeve të moszhvillimit dhe modelit më të mirë të tij u zhvendosën drejt idesë se “moszhvillimi është pasojë e mbizotërimit të vendeve të mëdha e të zhvilluara kapitaliste mbi vendet e varfra” e për pasojë, zhvillimi i tyre ishte i pamundur pa “konsensusin” dhe përkrahjen e këtyre.

Pikërisht, në fund të kësaj periudhe lulëzuan teoritë e “ndërvarjes” së ekonomive, të relacioneve “qendër-periferi”, të “këmbimeve jo të barabarta” etj.. Por, ngadalësimi i zhvillimit ekonomik botëror pas viteve `70–`80, i shoqëruar me të ashtuquajturën “krizë e borxheve”, të shkaktuar nga zbatimi i politikave monetare e financiare liberale, i dha fund iluzioneve të krijuara nga politikat intervencioniste dhe përgatiti terrenin drejt politikave tipike liberale. Ishte koha për të

vënë në zbatim “konsensusin e Washingtonit”, që përmblihet me sentencën: kredi zhvillimi nga Banka Botërore apo institucione të tjera ndërkombëtare mund të merren, vetëm në rastet kur zbatohen kriteret e rigorozitetit financiar të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Thelbi i këtyre politikave ishin kushtëzimet e paketës së “axhustimit strukturor” me objektiv themelor integrimin e vendeve në zhvillim në tregun botëror, që po shtrihej me shpejtësi në çdo cep të globit. Në këtë kontekst i filloi dhe Shqipëria reformat e para të periudhës së tranzicionit, gjatë viteve 1992-1995.

Por, realiteti i fundshekullit XX evidentoi shumë probleme thelbësore, në raport me objektivat e dëshiruar të zhvillimit. Rreth 3 miliardë persona në botë jetojnë me më pak se 2 usd në ditë; mbi 880 milionë prej tyre njohin për ditë urinë kronike ; 7 njerëzit më të pasur të botës zotërojnë shumën më të mëdha financiare se PBB-ja e 49 vendeve më pak të zhvilluara së bashku, vende ku jetojnë mbi 650 milionë banorë; me ritmin aktual të zhvillimit, konsiderohet se do të duhen 130 vjet për të eliminuar varfërinë në botë etj.. Këtyre shifrave, që dëshmojnë për dështimin e modeleve të propozuara për zhvillimin e shpejtë e të ekuilibruar të vendeve të varfra, i shtohen dhe mjaft katastrofa natyrore si për të plotësuar akoma më shumë kuadrin e një ekonomie globale, që ka si busull të vetme fitimin maksimal të menjëhershëm.

Përballë kësaj gjendjeje, në fund të shekullit XX pati mjaft reagime në funksion të debateve me fokus zhvillimin ekonomik e social:

Së pari, vetë institucionet financiare ndërkombëtare, e në radhë të parë Banka Botërore e Fondi Monetar Ndërkombëtar, partizane të politikave liberale e të rregullimit strukturor, futën në praktikën e tyre konceptin e “mirëqeverisjes” dhe objektivin kryesor “të luftës kundër varfërisë”. Gjithnjë e më tepër, kreditë e këtyre institucioneve po kushtëzohen nga rezultatet në luftën kundër korrupsionit në qeverisje dhe për pakësimin e varfërisë. Në këtë kontekst botëror edhe Shqipëria hartoi, që në vitin 2001, strategjinë e saj për rritjen ekonomike dhe pakësimin e varfërisë (GPRS).

Së dyti, Kombet e Bashkuara dhe PNUD-i, në unanimitet të plotë me mbi 150 kryetarë shtetesh lançuan objektivat globalë të

zhvillimit, të quajtur “Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit” dhe si instrument kryesor privilegjuan teorinë dhe praktikën e “zhvillimit të qëndrueshëm”. Në themel të kësaj platforme globale qëndron pakësimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik, social e mjedisor i çdo vendi. Edhe Shqipëria është një nga nënshkrueset e kësaj lëvizjeje botërore dhe nëpërmjet SKZHES po përpiqet të përparojë sa më shumë në drejtim të mobilizimit të të gjitha burimeve të mundshme, në funksion të këtyre objektivave.

Së treti, në kundërsens me këto tendenca, në shumë vende të botës është shfaqur së fundi dhe një korent tjetër, i cilësuar si “refuzues” i kësaj tendence globale, me argumentin se modelet e zhvillimit që propozohen janë specifike vetëm për perëndimin dhe kanë qëllim që të rrisin zotërimin ekonomik, politik e kulturor të tyre ndaj pjesës tjetër të botës. Përkrahësit e këtij korenti kërkojnë anulimin e marrëveshjeve me Bankën Botërore, FMN e OBT, largimin e qeverive të tyre nga bashkëpunimi me këto organizata, hartimin e politikave krejt të pavarura nga trendet dhe konsensusi global, propozimin e modeleve origjinale të zhvillimit etj..

TRE PYETJET THELBËSORE NDAJ MODELIT EKONOMIKO-SOCIAL NË SHQIPËRI

Po për Shqipërinë, cili do të ishte modeli më i përshtatshëm i zhvillimit ekonomik, kur tashmë ekziston një përvojë botërore e kombëtare mbi 50-vjeçare gabimesh e suksesesh? Vështirë se mund t'i jepet një zgjidhje përfundimtare, por të paktën të tentojmë t'i japim përgjigje tre prej pyetjeve thelbësore të një modeli ekonomik:

1. Rritje ekonomike apo zhvillim ekonomik e social? Cilët janë mekanizmat që e shndërrojnë rritjen ekonomike në zhvillim dhe a mund të konsiderohet rritja ekonomike si paradhoma e zhvillimit? Pra, ne duhet të përcaktojmë saktë përmbajtjen e rritjes dhe mënyrën e shpërndarjes së saj në pjesë të ndryshme të territorit e grupe të popullsisë. Në këtë pikë, Shqipëria ka filluar një kthesë rrënjësore. Në të gjitha debatet dhe dokumentet e natyrës strategjike apo zhvilluese siç është për shembull, SKZHES, krenaria e të kënaqurit vetëm me stabilitetin e treguesve makroekonomikë të rritjes po zëvendësohet

përditë e më shumë me përdorimin e treguesve të ekonomisë reale e zhvillimit social të shoqërisë të tillë si : përqindja e të varfërve dhe e shumë të varfërve, treguesit e plotësimit të nevojave bazë të popullsisë, treguesit e shërbimeve kryesore arsimore e shëndetsore, zhvillimi i infrastrukturës në të gjitha nivelet dhe kategoritë etj.. Thellimi i kësaj tendence në planifikimin, zbatimin dhe analizën e efekteve të përdorimit të fondeve publike e private dhe rialokimi strukturor i tyre, do të konsolidonte një model të mirë zhvillimi perspektiv për vendin. Zhvillimi i vendit do të nxitet së tepërmi nëse politika, akademikët, shoqëria civile, media, opinionistët të ndryshëm etj., do të fokusohen intensivisht në diskutimet e debatet që tentojnë t'i përgjigjen pyetjeve dhe sfidave themelore të zhvillimit.

2. Refuzim i recetave të organizmave ndërkombëtarë apo partneritet i plotë me to? Ka mjaft raste kur, në emër të një relativizmi kulturor e gjeopolitik apo novatorizmi ekonomik, kushtet e organizmave ndërkombëtarë për problemet e zhvillimit konsiderohen si “detyrime” apo “tutelë” për zhvillimin e vendit, duke sugjeruar madje dhe rritjen e “rezistencës” apo mosrespektimin e marrëveshjeve të përbashkëta. Natyrisht që, çdo vend është i pavarur në zgjedhjet e tij, por në kushtet e ekonomisë globale dhe të ndërvarjes gjithnjë e më të madhe ekonomiko-financiare të të gjitha vendeve të planetit, ajo që po kërkohet gjithnjë e më shumë është një botë me rregulla sa më të qartë si dhe rritja e transparencës dhe rolit rregullator e kontrollues të disa institucioneve ndërkombëtare (Banka Botërore, FMN, OBT etj.). Garancia e dhënë prej tyre në arenën ndërkombëtare për stabilitetin dhe seriozitetin e reformave të një vendi si dhe përfitimi nga përvoja globale e tyre, krijon premisa për rritjen e investimeve dhe të kapitalit ndërkombëtar në këto vende. E kundërta do të vinte shumë pikëpyetje për çdo vend që do të kërkonte në mënyrë aventurore, rrugë utopike individuale jashtë kontekstit dhe prirjeve ndërkombëtare. Prandaj, kombinimi i alternativave lokale, nacionale apo rajonale me një partneritet real me këta organizma ndërkombëtarë, do të rriste besueshmërinë e vendit dhe do të krijonte premisa reale për zhvillim të shpejtë e të qëndrueshëm.

3. Si t'i përcaktojmë raportet ndërmjet pasurimit dhe zhvillimit? A do të vazhdojmë ta konsiderojmë vetëm përmirësimin e të ardhurave

për frymë si treguesin bazë të zhvillimit ekonomik e social? Dhe në qoftë se përgjigja është jo, ashtu siç e kemi theksuar më lart, atëherë çfarë vendi duhet t'i akordojmë treguesve jomonetarë, shërbimeve publike, angazhimit joqeveritar etj., në debatet dhe strategjitë tona të zhvillimit? Treguesit më modernë që përdoren sot për të karakterizuar zhvillimin dhe mirëqenien janë më domethënës se PBB për frymë apo niveli i rrogave e pensioneve. Si të tillë mund të përmendim: treguesin e zhvillimit human, koeficientin Gini, treguesin e shëndetit publik, treguesin e pasurimit ekonomik, social dhe mjedisor; treguesin e zhvillimit të qëndrueshëm; koeficientin e pabarazisë sociale; treguesit e thellësisë dhe të ashpërsisë së varfërisë etj.. Janë pikërisht këta tregues ata që karakterizojnë në mënyrë të përmbledhur zhvillimin ekonomik e social të një vendi. Prandaj, të gjithë ata që direkt apo indirekt janë të përfshirë në debatet, strukturat programuese apo vendimmarrëse duhet t'i bëjnë pjesë të analizave e propozimeve të tyre kur flasin apo projektojnë modelin e zhvillimit perspektiv të Shqipërisë. Dhe kjo nuk duhet konsideruar si modernizim i gjuhës apo shprehje e intelektualitetit por, në rradhë të parë, si punë konkrete për t'i kuptuar e përvetësuar dhe pastaj për të përmirësuar gjithë sistemin statistikor e institucional të vendit, në funksion të ecurisë pozitive të tyre.

RELATIVITETI DHE KOHERENCA NË VLERËSIMIN E MODELEVE TË ZHVILLIMIT

Gjykimet dhe propozimet për sistemet ekonomike dhe modelet e zhvillimit, duhen parë si në kontekstin ku ato kanë lindur apo janë zbatuar ashtu dhe në kornizën e tyre teoriko-shkencore, pra të shkollës apo të rrymës që i përkasin. Dhe kjo sepse sot në botë ekzistojnë shumë shkolla apo rryma të mendimit ekonomik e platforma të zhvillimit, të cilat janë të konkretizuara në politika të caktuara ekonomike e sociale në vende apo nga popuj të ndryshëm. Nuk mund të jetë kurrësi reale apo me vlerë përgjithësuese (me përjashtim të shtimit të informacionit dhe shuarjes së kuriozitetit të lexuesve) një propozim apo një rekomandim që formulohet pak a shumë kështu: dhënia e pushtetit absolut të tregut e kombinuar me përvojën e Honkongut për llojin e qeverisë, me përvojën e Kilit në ekonomi, me politikat sociale nordike etj. etj.. Në këtë mënyrë të

ofrohet të lexosh (dhe të kuptosh) një tekst ku janë përdorur 4-5 lloj alfabetesh shumë të ndryshme nga njëri-tjetri. Le ta konkretizojmë këtë shqetësim me tre shembuj, të cilët dëshmojnë se të flasësh për pjesëza pa folur për të tërën nuk ka asnjë vlerë konkrete pozitive, përveçse konfuzionit intelektual e debateve mediatiko-politike.

Kur flasim për varfërinë në Shqipëri për shembull, si argument kryesor për të treguar se sa të varfër jemi përdoren vetëm “të ardhurat për frymë”, duke e ndarë popullsinë në disa grupe dhe ndërkohë propozojmë masa e politika konkrete në një fushë që ka nevojë për tregues, masa e këndvështrim tjetër. Për të qenë më konkretë : sot në botë ka tre shkolla bazë që analizojnë dhe interpretojnë varfërinë. Shkolla e quajtur “economic welfare”, e preferuar në mënyrë të veçantë nga Banka Botërore, sipas të cilës është niveli i mirëqenies ekonomike, pra i të ardhurave ai që përcakton nivelin e konsumit dhe plotësimin të nevojave individuale; shkolla e “nevojave bazë” sipas të cilës varfëria matet me një nivel të caktuar aksesi ndaj ushqimit, ujit të pijshëm, shërbimeve shëndetsore e arsimore, kushteve të banimit, transportit etj.; shkolla “e kapaciteteve njerëzore”, e preferuar së fundi nga UNDP-ja dhe disa personalitete botërore, çmime “Nobel” në ekonomi apo shkenca sociale, sipas të cilës konsiderohet i varfër një person që nuk ka kapacitetet e nevojshme të zhvillimit për të qenë në gjendje që të përfshihet e përfitojë nga të gjitha mundësitë ekonomiko-financiare e sociale në mjedisin ku jeton. Pra, këto janë tre llojet e “syzeve” me të cilat bëhet vlerësimi se sa të varfër jemi, dhe ç’është më e rëndësishmja, cilat janë politikat më të mira për ta luftuar varfërinë. Sepse të ulësh varfërinë nuk do të thotë vetëm rritje e të ardhurave për frymë, por dhe përmirësim i shërbimeve për nevojat bazë e mbi të gjitha rritje të kapaciteteve njerëzore për të qenë sa më të aftë për të dalë nga kjo varfëri. Vetëm duke i kombinuar të gjitha këto elemente, ne do të jemi realë në gjykimin për shkallën e varfërisë, do të propozojmë politika reale e konkrete apo do të nxisim e orientojmë drejt kreditë e investimet e të gjitha llojeve.

Një problem shqetësues në këtë këndvështrim janë dhe përmbajtja e programeve të ndryshme në universitetet tona, kryesisht ato që kanë të bëjnë me ekonominë, me financat dhe me politikat e zhvillimit. Shumë prej tyre janë pak koherente me shkolla apo rryma të konsoliduara ekonomiko-sociale bashkëkohore. Për shembull,

në rast se pedagogu i makroekonomisë ka studiuar në një vend anglo-sakson apo katedër universitare me preferenca liberale apo neoliberalë, rekomandohet se tregu është i gjithëpushtetshëm, se ndërhyrja e shtetit në ekonomi duhet të jetë sa më minimale etj., etj.; por ai i mikroekonomisë ka studiuar në një katedër tjetër që është e orientuar në rrymën regulacioniste e intervencioniste dhe thekson se shteti duhet të jetë i pranishëm në ekonomi, se ai duhet të bëjë politika mbështetëse etj., ndërkohë që një tjetër preferon shkollën institucionaliste apo neoinstitucionaliste dhe i jep përparësi faktit se institucionet dhe cilësia e funksionimit të tyre janë çelësi i suksesit, se raportet liri-individuele/institucion përcaktohen nga performanca e këtij të fundit, se shteti apo tregu janë edhe ata institucione si shumë të tjera në një shoqëri moderne e për pasojë, duhen parë në një sistem unik e tërësor etj., dhe së fundi, kur vjen radha e lëndëve që trajtojnë politikat e zhvillimit, dikush i apasionuar pas Ricardos i shpjegon teorinë klasike të përparësive krahasuese dhe efektit magjik të tregut për alokimin e burimeve, ndërkohë që dikush tjetër, më i afërt me problematikën e globalizimit, evidenton faktin se sot përparësitë krahasuese krijohen me politika specifike e konkrete, në varësi të koncepteve të reja të ndarjes së punës në shkallë botërore, të rajonit ku bën pjesë, të shkallës së hapjes apo integritimit të çdo vendi, të zgjedhjeve strategjike apo të kapaciteteve njerëzore etj.. Kështu, arrihet lehtë në përfundimin se sa koherent dhe i strukturuar do të jetë ky student kur të mbarojë fakultetin e do të përfshihet në vendimmarrje apo debatet e propozimet për qeverisjen dhe zhvillimin e vendit. Megjithëse jemi një vend i vogël, ka ardhur koha që shkollat tona të larta të profilizohen e konturohen më mirë në kurrikulat e tyre, përsa i përket rrymës apo shkollës së mendimit që ato preferojnë, dhe në qoftë se kjo është e vështirë për momentin, të paktën të evidentohet më qartë se nuk ka një zgjedhje të vetme, apo aq më keq, zgjedhje “mozaik” kur bëhet fjalë për një model zhvillimi apo për një paketë politikash ekonomike e sociale, por ka një sistem kompleks që fillon nga A –Zh, në koherencë të plotë në të gjitha elementet e tij. I takon pastaj politikës apo një konsensusi më të gjerë social e kombëtar se, cilin model apo politika do të preferojë më shumë në një moment të dhënë.

Flitet fare pak ose aspak për situatën specifike “pas-tranzicion” dhe për procesin e integritimit evropian të Shqipërisë parë në

kompleksitetin e tyre. Ne tashmë kemi kaluar nga një fazë e zbatimit të politikave të “rregullimit strukturor” të filluar që në vitin 1992, të cilat synonin para së gjithash në pakësimin e deficitit buxhetor, kontrollin e inflacionit dhe krijimin e tregut të lirë, në një fazë të re politikash ekonomike, që synojnë veçanërisht transformimet strukturore dhe zhvillimin ekonomik e social të qëndrueshëm. Dhe e gjitha kjo në një kontekst intensiv të përshtatjes së normave dhe standardeve evropiane.

Të hysh në Evropë do të thotë, veç të tjerave, të ndërtohet e konsolidohet dhe një sistem ekonomik-social kapitalist. Por, a kemi shtruar ndonjëherë ne pyetjen se: cili është modeli më i përshtatshëm i kapitalizmit për Shqipërinë? “Modeli evropian” mund të reagojë kushdo! Aspak. Kapitalizmi ka disa parime e rregulla bazë që përbëjnë thelbin e tij, por nga ana tjetër çdo vend e profilizon kapitalizmin sipas specifikave e zgjedhjes së tij. Franca ka zgjedhur modelin e “kapitalizmit shtetëror”, Gjermania dhe vendet nordike “kapitalizmin socialdemokrat”, Anglia “kapitalizmin liberal anglo-sakson” etj.. Prandaj dhe ekspertët apo politikanët tanë, të mos e reduktojnë çdo debat, analizë apo propozim vetëm te elemente të veçanta të modelit si për shembull, te tregu, liria e individit, përparësitë krahasuese, politikat sociale apo roli i shtetit dhe prania e tij, por ta trajtojnë në tërësinë e tij modelin. Kjo bëhet akoma më e rëndësishme po të kemi parasysh faktin se ne kemi ndërtuar “ekonominë e tregut”, por sa po kemi filluar të ndërtojmë kapitalizmin dhe të profilizojmë “modelin” e tij. Dhe ky model, nuk fillon e mbaron vetëm te tregu dhe liria individuale, por ai ka nevojë të gjykohet e të kristalizohet edhe duke marrë maksimalisht në konsideratë ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve specifike, forcimin e demokracisë dhe ligjshmërisë të të gjithë aktorëve të zhvillimit, dinamikat politike si dhe faktorët psikologjikë e kujtesën historike të çdo vendi.

Prandaj, përpara se t'i referohemi vetëm dhe ekskluzivisht një elementi të veçantë të modelit apo vetëm një shkollë si për shembull, asaj “ultraliberale”, le të preferojmë më shumë këndvështrimin tërësor të modelit apo sistemit, analizën krahasuese historike dhe gjeografike, si dhe përvojën e problematikën e vendeve të tjera të Evropës Qendrore e Lindore, që tashmë janë integruar në Bashkimin Evropian, i cili përbën dhe objektivin tonë historik kombëtar.

VIZIONI AFATGJATË DHE STRATEGJIA SI PERSPEKTIVË

Përcaktimi i një vizioni afatgjatë 15-20 - vjeçar të zhvillimit ekonomik e social, përbën sfidën kryesore në Shqipëri. Duke respektuar tendencat bazë të politikave ekonomike të ndjekura (stabiliteti makroekonomik, reduktimi dhe eliminimi i varfërisë absolute e relative, reduktimi i deficitit tregtar, nxitja e prodhimit vendas dhe fuqizimi i sektorit privat, forcimi institucional i institucioneve publike e jopublike etj., dhe të gjitha këto të para nën këndvështrimin e integritimit evropian) duhet të synohet që të përcaktohen disa tregues konkretë të këtij zhvillimi afatgjatë 15-20 - vjeçar. Pjesa dërrmuese e treguesve duhet të gjejë konsensusin e gjithë spektrit politik e shkencor shqiptar dhe të jetë rruga kryesore e zhvillimit; duke mos u cënuar nga ndryshimi i orientimit politik të qeverisjes. Kjo do të bëjë që shprehja tipike, që gjendet në shumicën e librave që flasin për strategjitë që “e keqja e çdo strategjie zhvillimi janë mandatat e kufizuara qeveritare” të fillojë të ketë vetëm vlera paralajmëruese e pedagogjike dhe jo efekte konkrete.

Shqipëria ka nevojë të kristalizojë një model zhvillimi të përshtatshëm për kushtet dhe situatat konkrete dhe ta bëjë atë pjesë të aktivitetit të të gjitha strukturave dhe institucioneve të saj. Ne duhet t'i japim sa më shpejt përgjigje zgjedhjes së modelit strategjik që do përshtasim:

(i) zhvillim i ekuilibruar apo proporcional, çka nënkupton një shpërndarje proporcionale të financimeve e investimeve në të gjithë sektorët e ekonomisë, ndërkohë që realizimi i një “Big Push” do të kërkonte një ndërhyrje energjike shtetërore në kuadrin e një programi kompleks zhvillimi dhe burimesh financiare të konsiderueshme, duke pasur brenda pikëpyetjen e madhe: të zhvillojmë gjithë sektorët apo të orientohemi nga sektorët që paraqesin përparësi krahasuese në kuadrin e hapjes rajonale e globale?; apo

(ii) zhvillim i disbalancuar, çka nënkupton një zhvillim me disa etapa dhe me përparësi selektive për financimet e brendshme dhe investimet e huaja. Kjo lloj zgjedhje ka dhënë rezultate shumë të mira në ato vende në zhvillim që kanë privilegjuar hapjen e tregjeve dhe

integrimin e shpejtë në ekonominë botërore, por që nga ana tjetër janë përballuar dhe me tensione të forta sociale e kriza politike.

Në përcaktimin e këtij modeli strategjik kërkohet të mbahen parasysh tre momente kryesore: (i) hapja e një debati të gjerë specialistësh, ekspertësh, akademikësh, përfaqësuesish të shoqërisë civile etj., për përcaktimin e këtij modeli; (ii) realizimi i një studimi të thelluar kombëtar mbi faktorët e rritjes dhe mundësitë reale të zhvillimit të vendit; (iii) ngritja e një institucioni të specializuar për hartimin e politikave strategjike të zhvillimit dhe kordinimin në nivel kombëtar të këtij procesi. Në zhvillimin e saj, Shqipëria duhet të fillojë të zbatojë në mënyrë konsistente, parimet e “zhvillimit të qëndrueshëm” dhe t’i bëjë ato pjesë të logjikës së përditshme të zhvillimit. Duhet të privilegjohej më shumë logjika e zhvillimit territorial ose siç quhet ndryshe horizontale, përkundrajt logjikës sektoriale apo vertikale që mbizotëron sot. Kjo kërkon dhe një ndryshim të vetë strukturave dhe punës së institucioneve publike e jopublike për t’i dhënë më shumë vend logjikës institucionale të tipit “cross-cutting”. Kordinimi më i mirë e më rigoroz i donatorëve, financimeve e ndihmës së huaj etj., përbën një faktor tjetër në favor të zhvillimit të ekuilibruar e të qëndrueshëm.

RRITJA E QËNDRUESHME DHE ROLI ORIENTUES E STABILIZUES I SISTEMIT FINANCIAR

Në një vlerësim mbi ecurinë dhe problematikën e tranzicionit në Shqipëri të realizuar nga Banka Botërore (2005), ndërsa shprehej optimizëm mbi performancën ekonomike në Shqipëri, ngrihej dhe shqetësimi për ruajtjen e qëndrueshmërisë së kësaj rritjeje në periudhën afatmesme e afatgjatë. Megjithëse Shqipëria ka një rritje ekonomike konstante prej rreth 6 për qind për 7-8 vitet e fundit, duke qenë kështu përvoja më e lartë rritëse në gjithë Evropën Lindore, një analizë më e thelluar e rritjes ekonomike dhe trendeve të saj dëshmon se ajo duhet parë në dy aspekte apo grupe faktorësh: ekstensivë dhe intensivë. Mbështetur në raportin e Bankës Botërore, gjykohet se Shqipëria mbas një periudhe të gjatë tranzicioni tashmë po i afrohet fundit të shfrytëzimit ekstensiv të burimeve dhe faktorëve që kushtëzojnë rritjen ekonomike, dhe natyrshëm lind

pyetja: çfarë duhet bërë që kjo rritje të jetë po kaq e qëndrueshme dhe në të ardhmen? Në reformat aktuale e në perspektivë duhet të privilegjojen më shumë faktorët intensivë të tillë si: rritja e normës së akumulimit të kapitalit, nxitja e investimeve dhe jo e konsumit, reforma të thella strukturore, thellimi i hapjes ekonomike dhe rritja e aftësisë konkurruese, thellimi i disiplinës fiskale, transferimi i efekteve të rritjes në reduktim të varfërisë, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe formimit profesional, përmirësimi i infrastrukturës publike, cilësia e institucioneve dhe mirëqeverisja etj..

Spektori bankar po luan një rol gjithnjë e më të dukshëm në nxitjen e rritjes ekonomike të vendit. Vetëm gjatë vitit 2004, bankat kanë dhënë rreth 100 miliardë lekë kredi të reja duke dhënë “karburantin” e nevojshëm, por megjithatë ende të pamjaftueshëm për kërkesat dinamike të ekonomisë shqiptare. Gjatë vitit të fundit, sistemi i kredisë ka evidentuar dy fenomene shumë pozitive : së pari, rritja e kredisë në lekë, e cila përbën tashmë rreth 33 për qind të totalit. Rritja e peshës së kredisë në lekë përbën një zhvillim pozitiv për faktin se ai shënon një rritje të pjesëmarrjes së pjesës më të madhe të mjeteve monetare të ekonomisë në mbështetjen e aktiviteteve prodhuese dhe tregtare. Njëkohësisht, ky zhvillim do të shoqërohet me rritjen e efektivitetit të politikës monetare, e cila do të ketë një efekt më të shpejtë dhe më të drejtpërdrejtë mbi tregjet ekonomike dhe financiare; dhe së dyti, rritja e kredisë në drejtim të bizneseve prodhuese dhe ulja relative e kredisë për biznese tregtare, duke përbërë një bazë të mirë për rritjen ekonomike në të ardhmen. Kështu, sektori i tregtisë që deri në vitin 2002 ka thithur mbi 40 për qind të totalit të kredisë së lëvruar nga ana e sistemit bankar, në vitin 2004 ka marrë vetëm 23 për qind të tij, ndërkohë që është rritur ndjeshëm kredia për sektorët prodhues dhe teknologjitë e reja. Prirja pozitive e kësaj strukture të re lidhet me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në të cilin biznesi prodhues konsiderohet si shtylla kurrizore e rritjes ekonomike. Aktualisht, kemi një klimë më pozitive në marrëdhëniet bankë-biznes, të cilat po zhvillohen në drejtim të rritjes së kreditimit të ekonomisë. Bankat po rrisin praninë e tyre në të gjithë vendin e po konsolidohen, bankat po kërkojnë të jenë sa më të shëndetshme e po e rinvestojnë kapitalin e tyre në teknologji dhe ç’është më kryesorja, po krijojnë një rrjet të gjerë pagesash e shërbimesh duke synuar edhe një pakësim sa më të madh të cash-it në ekonomi si edhe reduktimin e ekonomisë informale.

Realizimi i një niveli rritjeje ekonomike të qëndrueshme, të parashikuar prej 6 për qind edhe për periudhën afatmesme 2005-2008 është ambicioz por gjithsesi realist, pasi në kuadrin e SKZHES, objektivi bazohet në politika specifike që synojnë nxitjen e rritjes ekonomike, mobilizimin më të mirë të burimeve bazë të rritjes si dhe pakësimin e pengesave që veprojnë ndaj saj. Në terma më konkretë, ashtu siç u evidentua dhe në raportin e fundit të Bankës Botërore, rritja në Shqipëri vazhdon të përcaktohet nga disa faktorë kryesorë si: stabilizimi makroekonomik, ecuria e implementimit të reformave strukturore, niveli i produktivitetit të disa prej sektorëve që ndikojnë ndjeshëm në PBB, efektet e emigracionit dhe dërgesat monetare etj..

Në këtë kontekst, duke parë dhe trendin e 3-4 viteve të fundit, konstatohet një tendencë pozitive që pritet të vazhdojë dhe në periudhën afatmesme 2005-2008 :

(i) Treguesit makroekonomikë jo vetëm që janë stabilizuar por disa prej tyre pritet të përmirësohen: inflacioni pritet të jetë nën kontroll të plotë në intervalin 2-4 për qind, borxhi i brendshëm dhe i jashtëm më të reduktuar, vlera e lekut konstante, deficitit buxhetor në ulje në raport me PBB-në, qëndrueshmëri dhe performancë fiskale më e lartë si dhe mbështetje kryesore tek të ardhurat tatimore, rritja e nivelit të kursimeve kombëtare etj..

(ii) Realizimi i reformave të rëndësishme strukturore si: privatizimi i Albtelekomit, Armos, i BISH etj., reformat në KESH, privatizimi i INSIG, ristrukturimi i disa ndërmarjeve të rëndësishme publike, pakësimi i barrierave të investimeve i shoqëruar me reforma institucionale, përmirësimi i statistikave ekonomiko-financiare etj..

(iii) Parashikohet që në vazhdim ekonomia shqiptare të kreditohet çdo vit 30-40 për qind më shumë ; disa nga bankat kryesore të nivelit të dytë si “Raiffeisen”, “Tirana”, “ProCredit” etj.. kanë evidentuar shifra të larta kreditimi që pritet t’u jepen kryesisht bizneseve, që nga viti 2005 e në vazhdim në fushën e tregtisë, industrisë, ndërtimit e agropërpunimit, duke i dhënë “energjinë” e duhur “motorit” të ekonomisë.

(iv) Disa nga sektorët e rëndësishëm të ekonomisë pritet të ndjekin trendet pozitive të vitit 2004, për shembull, turizmi i cili vetëm gjatë vitit 2004 u rrit 15 për qind pritet të vazhdojë rritjen; industria nxjerrëse e mineraleve si krom, bakër etj., të cilat po i rikthehen eksporteve, prodhimi i çelikut, i hekurit, rritja e importeve për makineri, pajisje e teknologji gjatë 2-3 viteve të fundit; shtimi i sipërfaqes së serrave, vreshtave e pemtoreve etj.; pritet të vazhdojë mbështetja e BE-së, Gjermanisë, Italisë dhe e mjaft vendeve të tjera për biznesin, SME-të, decentralizimin, shërbimet etj., dhe së fundi, edhe dërgesat monetare të emigrantëve, megjithë një tendencë afatgjatë uljeje, nuk pritet të kenë ndryshime negative në një periudhë afatshkurtër e afatmesme.

Sfidat kryesore të rritjes së qëndrueshme e afatgjatë janë: shpërndarja sa më e ekuilibruar e efekteve të saj në gjithë rajonet e vendit dhe grupet e ndryshme të popullsisë; ndikim direkt në uljen e nivelit të varfërisë; sigurimi i rritjes nëpërmjet mobilizimit dhe angazhimit të sa më shumë sektorëve, aktiviteteve e degëve të ekonomisë si për shembull, zhvillimi i bujqësisë dhe i agroindustrialit etj.. Ndërkohë, disa nga rreziqet dhe pengesat që duhen të mbahen më shumë në konsideratë apo duhen reduktuar janë: efekti negativ i tensioneve politike; aftësia konkurruese akoma e ulët e ekonomisë shqiptare; efikasiteti i shndërrimit të procesit të hapjes dhe liberalizimit tregtar në rritje ekonomike të qëndrueshme; eliminimi i informalitetit të tregut dhe përmirësimi i institucionalizimit të tij; garantimi i një mjedisi sa më konkurrencial për biznesin; paqartësitë mbi pronësinë e tokës; mirëqeverisja në kuptimin e gjerë të saj; niveli dhe aftësia thithëse e investimeve të huaja direkte; niveli i mbikëqyrjes bankare; vonesat apo devijimet nga ritmi dhe gjerësia e reformave strukturore etj.. Një rrezik i mundshëm që mund të çenojë nivelin e rritjes, është koniuktura jo e favorshme e ekonomisë botërore në përgjithësi, çmimi i naftës, çmimet e lëndëve të para strategjike, normat e interesit etj., që pritet të rriten, duke e bërë më të ashpër konkurrencën në tregjet ndërkombëtare dhe për pasojë, të ndikojnë direkt apo indirekt në gjithë sistemin ekonomik-financiar të Shqipërisë.

LITERATURË

“Albania – National human development report” (2005), SEDA & UNDP, Tirana, Albania.

“Albania Poverty Assessment” (2003), Document of the World Bank, Report No. 26213 – AL.

“Analizë në vite e shpenzimeve publike në Shqipëri” (2005), Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë.

“Raporti i progresit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social për vitin 2003”, Ministria e Financave, 2004.

“Raporti i progresit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social për vitin 2004”, Ministria e Financave, 2005.

“Shqipëria – Rruajtja e Rritjes së Qëndrueshme edhe përtej Tranzicionit”, Memorandum Ekonomik i Bankës Botërore për Shqipërinë, dhjetor 2004 (Raport Nr. 29257-AL).

ACIT (2005), “Raporti vjetor i tregtisë së jashtme – 2004”, ACIT, Tiranë 2005.

IMF (2004), “World economic outlook – the global demographic transition”, Washington DC, Economic and financial surveys.

Jeffrey Sachs (2001), “Nouvelles approches en matière d'aide internationale », Harvard University, Conférence sur le développement international, 19 juin 2001, Ottawa, Canada.

Maddison, A., (1994) “Economic growth and structural change: comparative approaches over the long run”, Actes du 11 Congrès International d'histoire économique, Milan, Italy.

OCDE (2001), “The world economy – a millennial Perspective”, Paris, France.

OCDE (2003), “Globalisation, poverty and inequality”, Paris, France.

OCDE (2004), “Institutional efficiency and its determinants – the role of political factors in economic growth”, Paris, France.

Young & Quinn (2002), “Writing effective public policy papers”, Budapest, Hungary.

SHËNIME

* Adrian Civici: Drejtor i Departamentit të SKZHES. Ministria e Financave.

** Ina Kraja: Drejtore e Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun. Banka e Shqipërisë.